

DREJTËSIA

DITARI MUJOR

MANJA ME NOTERËT: MBRONI QYTETARËT, MOS U BËNI PALË



Ministri i Drejtësisë z. Ulsi Manja ka shfrytëzuar Mbledhjen e Përgjithshme të Asamblesë Kombëtare të Noterëve për të dhënë disa mesazhe si dhe ngritur disa probleme. Pikësëpari duke synuar mbrojtjen e qytetarëve z.Manja ka kërkuar që noterët të mos bëhen palë me institucionet financiare jo banka (si mikrokreditë) e mbi të gjitha theksoi ai: "...noterët e kanë detyrim t'u lexojnë qytetarëve detyrimet e kontratave, sepse në shumë raste qytetarët kanë mbetur peng i këtyre institucioneve". Po ashtu Manja nuk ka hezituar t'u kërkojë bashkëpunim noterëve të ndershëm për pastrimin e rradhëve të tyre nga elementët që e bëjnë pis këtë shërbim. "Për këtë qëllim kemi ngritur dhe kanë nisur inspektimet tematike dhe në çdo heqje liçense unë do të bëj dalje publike duke renditur abuzimet e kujtdo qoftë", ka paralajmëruar ai.

LEXO PËR MË SHUMË

MD TRYEZA KONSULTATIVE RRETH PROJEKTLIGJIT "PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE"

Ministria e Drejtësisë ka nisur tryezat konsultative të një prej nismave ligjore më të rëndësishme në forcimin e mekanizmave mbrojtës të të dhënave personale. Kanë nisur sot në Ministrinë e Drejtësisë tryezat konsultative për projektligjin "Për mbrojtjen e të dhënave personale". Sipas Ministrit të Drejtësisë z. Ulsi Manja "përmbushim një prej detyrimeve që buron nga procesi i integritimit në Bashkimin Evropian, për përafrimin plotësisht të legjislacionit shqiptar me Rregulloren e Përgjithshme të BE për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Direktivës për përpunimin e të dhënave personale nga organet ligjzbatuese". Projektligji "Për mbrojtjen e të dhënave personale" ka disa ndryshime të rëndësishme krahasuar me ligjin në fuqi si: përmirësimi i termave të përdorur, përmirësimi dhe zgjerimi i të drejtave të subjekteve, rritja e mbrojtjes së të dhënave personale, rregulla për përpunimin nga autoritetet i të dhënave etj.



LEXO PËR MË SHUMË

HARTA E RE GJYQËSORE MIRATOHET NË KËSHILLIN E MINISTRAVE

Pas një periudhe pune tre vjeçare nga ekspertët më të mirë shqiptarë, pas shumë dëgjësash publike, pas sugjerimeve të ardhura nga grupe të ndryshme interesi, qeveria ka miratuar Hartën e re Gjyqësore. Ka qenë një proces i gjatë, ku të përfshirë përveç Ministrisë së Drejtësisë dhe KLGJ ka pasur edhe ekspertë ndërkombëtarë si dhe nuk ka munguar ndihma teknike e Shteteve të Bashkuara. Pas mbledhjes së qeverisë, Ministri i Drejtësisë z.Ulsi Manja është shprehur se: "Shqipëria do të ketë 13 Gjykata të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, një Gjykatë Apeli me juridiksion të Përgjithshëm dhe dy Gjykata Administrative të shkallës së parë Miratimi i hartës së re është një hap i rëndësishëm në zbatimin e Reformës në Drejtësi". Manja ka vlerësuar punën e bërë nga KLGJ si dhe ndihmën e dhënë nga ekspertët e huaj. Ai ka qetësuar qytetarët duke u shprehur: "Në gjykatat qytetarët do t'i marrin të gjitha shërbimet



gjyqësore në strukturat egzistuese të gjykatave. Po ashtu implementimi i hartës do të bëhet me faza, në 1 Shkurt do të kemi përqendrimin e Gjykatës së Apelit, në 1 Maj. gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe në 1 Korrik gjykatat administrative". Sipas Ministrit të Drejtësisë harta e re ka disa risi si standartizimi do të i kohës mesatare të dhënies së vendimit, shpërndarja e drejtë e çështjeve me një short real të gjyqtarëve, ulja e kostove në dhënien e drejtësisë etj. Gjithsesi Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor do ta shfrytëzojnë periudhën kalimtare të implementimit të hartës së re për familjarizimin dhe ambientimin e qytetarëve me gjykatat e reja.

LEXO PËR MË SHUMË

FOTO LAJM



SHQIPËRIA HAP NEGOCIATAT ME BE.
NEGOCIATORJA E MD,
ZV/MINISTRIA ZNJ. ADEA PIRDENI NË
TRYEZËN E PARË NDËRQEVERITARE.



KTHEHET NË ITALI NJË ARTEFAKT I
GRABITUR NË KONSERVATORIN E
PARMËS. KLAVIKORDA ME AUTOR TË
PANJOHUR I PËRKET SHEK.XVIII .



TEMPERATURAT E LARTA, MINISTRI I
DREJTËSISË INSPEKTON IEVP LEZHË PËR
KUSHTET, POROSIT KUJDES NDAJ
COVID19.



Ministria e Drejtësisë
Ulsi Manja



ministra_drejtises
ulsimanja



@manja_ulsi